

VENDIM
Nr.267, datë 21.4.2010

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS SË ALUIZNI-T ME ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE AGJENCINË E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit e të Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) bën verifikimi në terren të njësive të ndërtuara menjëherë pas paraqitjes së kërkesës dhe pas kryerjes së parapagesës së tarifës nga subjekti i interesuar apo personi i stimuluar.

2. ALUIZNI, për verifikimin e gjendjes juridike të pronës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i verifikimit në terren i njësive ndërtimore, kërkon nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) informacion për gjendjen juridike të zonës së stimuluar, të shoqëruar me kopjen e dokumentacionit që disponohet (kartelë apo regjistër hipotekor, hartë treguese të pasurisë, dokumentacioni ligjor i regjistrimit të pasurive dhe i transaksioneve të mundshme).

3. Nëse ZVRPP-ja konfirmon se zona e stimuluar është pronë shtetërore, ALUIZNI bashkërendon punën edhe me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) për të evidentuar, kur është e mundur, nëse ka:

a) vendime të ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronës, pranë bashkive ose këshillave të qarkut, ose të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për njohje, kthim ose kompensim të pronës.

b) kërkesa në proces shqyrtimi, të depozituara nga subjekte, të cilat pretendojnë të drejtën e pronësisë mbi zonën e stimuluar.

Kërkesa për marrjen e informacionit i dërgohet AKKP-së, pas përfundimit të afatit të parashikuar në ligj, për paraqitjen e kërkesave nga subjektet e interesuara apo personat e stimuluar.

4. Institucionet e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij vendimi, e dërgojnë informacionin e kërkuar, pranë drejtorisë qendrore të ALUIZNI-t, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

5. ALUIZNI, pas verifikimeve të mësipërme, harton relacionin shpjegues sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”.

6. Ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha